



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 189

4 dhjetor

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK nr. 48, datë 15.11.2013	Me objekt deklarinimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, me Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kartën Sociale Evropiane, të pikave 7 dhe 9, të nenit 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.....	7873
Vendim i GJK nr. 49, datë 21.11.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.255, datë 10.02.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; të vendimit nr.282, datë 09.10.2009 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr.00-2012-2408, datë 15.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	7880
Vendim i GJK nr. 50, datë 21.11.2013	Me objekt: Konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 1036, datë 07.08.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm; Dëmshpërblimim e dëmit të ardhur nga mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë.....	7882
Vendim i GJK nr. 51, datë 21.11.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve: nr.2080, datë 23.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (pjesërisht); nr.792, datë 15.04.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.00-2011-296, datë 06.04.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	7886

VENDIM
Nr. 48, datë 15.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	Anëtar i “ “
Gani Dizdari	Anëtar i “ “
Besnik Imeraj	Anëtar i “ “
Fatos Lulo	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 21.05.2013 mori në shqyrtim, në seancë plenare, çështjen nr. 12 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, përfaqësuar nga z.Sinan Tafaj;

Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara, përfaqësuar nga z.Sinan Tafaj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë;

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim nga z. Armir Juka;

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësuar me autorizim nga znj.Klodiana Kamberaj.

OBJEKTI: Deklarimi si të papajtueshme me Kushtetutën, me Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kartën Sociale Evropiane, të pikave 7 dhe 9, të nenit 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 15, 18, 31/ç, 45, 46, 122, 134/f të Kushtetutës; nenet 1/2, 28, 49/2, 51/a, b, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Bashkim Dedja, shqyrtoi pretendimet e kërkuësve, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës; prapësimet e subjekteve të interesuara, të cilat kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (ligji për mbrojtjen nga diskriminimi/ “Ligji”). Ky ligj ka për objekt të rregullojë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Gjithashtu, Kuvendi ka ratifikuar me ligjin nr.108, datë 15.11.2012, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Kjo konventë ka për qëllim të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur.



2. Në datën 08.03.2013, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë dhe Këshilli Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuar (kërkuesit), i janë drejtuar, me kërkesa të veçanta, Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e pikave 7 dhe 9 të nenit 3 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për papajtueshmëri me parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, përcaktuar në nenin 18 të Kushtetutës, si dhe me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KPAK).

3. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3 përkufizon kuptimin e disa termave të përdorura në këtë ligj. Në pikën 7 të këtij neni sanksionohet që: “*Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një *barrë të tepruar*, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Ndërsa, po në të njëjtin nen, në pikën 9 sanksionohet që: “*Organizatat me interesa legjitime*” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.

4. Në datën 05.04.2013, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, gjatë shqyrtimit paraprak, vendosi kalimin e çështjeve në seancë plenare dhe bashkimin në një të vetme, duke qenë se kërkesat e paraqitura nga të dy kërkuesit janë me të njëjtin objekt kërkimi dhe me të njëjtat argumente.

II

Pretendimet e palëve

5. **Kërkuesit**, duke pretenduar papajtueshmërinë me Kushtetutën të përkufizimeve ligjore të sipërcituara, kanë argumentuar se:

5.1 Shprehja “barrë të tepruar” në pikën 7 të nenit 3 të Ligjit, i përkufizon në mënyrë të qartë veprimet e shtetit si një barrë për akomodimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

5.2 Ligji, por edhe akte nënligjore konkrete, nuk kanë parashikime që ta bëjnë të matshme barrën e tepruar. Në këtë mënyrë, personat me aftësi të kufizuara ndodhen përballë rrezikut që për ta të përcaktohen rregulla dhe kritere, që i diferencojnë nga qytetarët e tjerë.

5.3 Ky kufizim dhe përkufizim është vendosur vetëm për personat me aftësi të kufizuara dhe jo për grupet e tjera, nga ku del qartë se personat me aftësi të kufizuara trajtohen në mënyrë të diferencuar nga ligji, në raport me grupet e tjera.

5.4 Përkufizimi mbi organizatat me interesa legjitime, sipas pikës 9 të nenit 3 të Ligjit, nuk diferencon organizatat e personave **me** aftësi të kufizuara, pra që në anëtarësi kanë persona me aftësi të kufizuara, nga organizatat **për** persona me aftësi të kufizuara.

5.5 Ligji, duke ofruar një përcaktim të përgjithshëm dhe duke mos marrë parasysh realitetin e deformuar dhe të disbalancuar në praktikë, nuk garanton shmangien e abuzimit dhe të konfliktit të interesave ndërmjet individëve me aftësi të kufizuara, të organizuar në shoqatat e tyre, dhe organizatave të tjera që si objekt statutor kanë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

5.6 Konventa për Personat me Aftësi të Kufizuara ndan qartë konceptin e organizatave përfaqësuese të përbëra nga vetë personat me aftësi të kufizuara, nga organizatat e tjera të shoqërisë civile, që janë krijuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

6. **Kuvendi**, si palë e interesuar, në parashtrimet me shkrim, ka paraqitur këto argumente:

6.1 Kërkuesit duhet të argumentojnë interesin e tyre, si kriter për legjitimitimin. Kërkesa e paraqitur është e bazuar tërësisht në paragjykime, mbi rreziqe të supozuara, kjo pasi në afatin kohor 3-vjeçar, nuk është paraqitur asnjë ankim tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga subjekte publike apo private.

6.2 Kërkesa për papajtueshmëri të Ligjit me Kushtetutën, në lidhje me termin “barrë e tepruar”, në thelb, është një pretendim për sqarim termash dhe pasaktësi përkthimi, sesa realisht problematikë gjykimi kushtetues.

6.3 Termi “organizata me interesa legjitime” është përkufizues dhe duhet parë i lidhur ngushtë me dispozitat e tjera të Ligjit, konkretisht nenet 32, 33/1 dhe 2, dhe 34.

6.4 Në një treg konkurrues, organizatat jofitimprurëse luftojnë për të siguruar donacione, dhe sigurisht që ato që veprojnë brenda të njëjtës fushë konkurrojnë me projekte për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sipas normave kombëtare e ndërkombëtare.

7. **Këshilli i Ministrave**, si palë e interesuar, ka parashtruar këto argumente:

7.1. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ka për qëllim sigurimin e barazisë efektive për të gjitha subjektet që ndodhen në fushën e zbatimit të tij.

7.2 Ligjvënësi ka vlerësuar se përshtatja e arsyeshme në favor të personave me aftësi të kufizuara duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale, prandaj dhe ka përdorur termin “barrë e tepruar”.

7.3 Termi “organizata me interesa legjitime” nuk mbart asnjë problem kushtetues. Nëse do të bëhej dallimi në ligj mes kategorisë së organizatave sipas anëtarësisë, atëherë do të krijohet diskriminim mes organizatave, në varësi të themeluesve të tyre.

8. **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, si palë e interesuar ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto argumente:

8.1 Termi ligjor “barrë e tepruar” nuk bie në kundërshtim as me Kushtetutën dhe as me KPAK-un, sepse është përdorur në kuptimin e një barre disproporcionale;

8.2 Termi ligjor “organizata me interesa legjitime” nuk bie në kundërshtim me nenin 12 të KPAK-ut, pasi ky nen nuk ka të bëjë me rregullat e përfaqësimit, por me rregullimin e zotësisë juridike për të vepruar.

8.3 Nëse neni 3/9 i Ligjit mbi mbrojtjen nga diskriminimi, do të bënte dallimin mes dy kategorive të organizatave *për* dhe *me* persona me aftësi të kufizuara, atëherë do të krijonte diskriminim.

III

Vlerësimi i Gjykatës

Për legjitimitimin e kërkuësve

9. Çështjen e legjitimitimit, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar interesin që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

10. Për sa i përket legjitimitimit të shoqatave, si subjekte iniciuese, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimitimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti që dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo mbi kërkuësin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuësit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr.33, datë 24.06.2010; nr.4, datë 23.02.2011; nr.43, datë 06.10.2011; nr.37, datë 13.06.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kuvendi, si palë e interesuar, ka pretenduar se kërkuësit nuk legjitimohen, pasi kërkesa është e bazuar tërësisht në paragjykime mbi rreziqe të supozuara dhe nuk prezanton një shqetësim serioz mbi pasojat antikushtetuese të Ligjit. Këtë argument Kuvendi e mbështet në faktin se në afatin ligjor 3-vjeçar për paraqitjen e ligjit para Gjykatës Kushtetuese, nuk është paraqitur asnjë ankim tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga subjekte publike apo private.



12. Gjykata çmon se çështja, e cila ka për objekt mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka lidhje me veprimtarinë ligjore të kërkuesve, si dhe prek në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat kushtetuese të anëtarëve të shoqatave. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkesat *prima facie* janë paraqitur me shkaqe dhe argumente të mjaftueshme *ratione materiae*, në funksion të kontrollit kushtetues të dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi. Rrjedhimisht, kërkuesit legjitimohen në këndvështrim të nenit 134/2 të Kushtetutës.

Për pretendimin për cenim të parimit të barazisë, në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës

13. Sipas nenit 18 të Kushtetutës, të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

14. Gjykata, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Konkretisht, ajo është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (*shih vendimet nr.34, datë 20.12.2005; nr.39, datë 16.10.2007; nr.4, datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata rikonsideron se organi ligjvënës është i detyruar t’i përmbahet këtij parimi kur bëhet fjalë për “barazinë në ligj”. Në lidhje me mosdiskriminimin, ajo ka përcaktuar disa standarde, me anë të të cilave ka synuar të vlerësojë nëse një ligj është diskriminues në termat e nenit 18 të Kushtetutës. Kështu, Gjykata shqyrtton nëse ligji ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se po, a ka qenë diferencimi i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligjje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm. Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, prandaj Gjykata, në rast trajtimi të njëjtë të subjekteve, shqyrtton nëse ligji duhet të kishte pasur diferencim mbi një arsye legjitime dhe objektive, pasi ato (subjektet) paraqiten me specifika faktike të ndryshme.

16. Gjykata konstaton se ligji për mbrojtjen nga diskriminimi e konkretizon nenin 18 të Kushtetutës, pra respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimin në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Po sipas këtij ligji, parimi i barazisë nënkupton: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, (*neni 1 dhe 2 i Ligjit*).

17. Nën dritën e këtyre konsideratave të përgjithshme mbi parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, Gjykata vlerëson të analizojë veçmas pretendimet në lidhje me përkufizimet ligjore të kundërshtuara.

A. Për pretendimin për diskriminim, për shkak të konceptit ligjor “barrë të tepruar”, përcaktuar në pikën 7 të nenit 3 të Ligjit

18. Sipas kërkuesve, shprehja “barrë të tepruar” në pikën 7 të nenit 3 të Ligjit, i përkufizon në mënyrë të qartë veprimet e shtetit si një barrë për akomodimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Ky kufizim dhe përkufizim është vendosur vetëm për personat me aftësi të kufizuara dhe jo për grupet e tjera, nga ku del qartë se personat me aftësi të kufizuara trajtohen në mënyrë të diferencuar nga ligji, në raport me grupet e tjera të shoqërisë.

19. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, ky pretendim në thelb është një pretendim për sqarim termash dhe pasaktësi përkthimi sesa realisht problematikë gjykimi kushtetues. Subjekti tjetër i interesuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi sqaron se kuptimi i këtij termi është, se në çdo rast, kur gjykohet lidhur me detyrimin për të realizuar një përshtatje të arsyeshme për personat me aftësi të kufizuara, sidomos në fushën e punësimit, duhet që përshtatja të jetë e arsyeshme dhe të mos përbëjë barrë disproporcionale për punëdhënësin. Të njëjtat argumente paraqet dhe Këshilli i Ministrave.

20. Gjykata çmon se në rastin konkret, lidhur me ekzistencën e diskriminimit që mund të përmbajë shprehja “barrë e tepruar”, për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, krahasuar me kategoritë e tjera, subjekte të Ligjit, paraprakisht do të paraqesë disa konsiderata, në lidhje me konceptin ligjor “përshtatje e arsyeshme”, brenda të cilit është përdorur shprehja “barrë e tepruar”.

21. Gjykata konstaton se termi “përshtatje e arsyeshme” është zbërthyer nga neni 2 i KPAK-ut, sipas të cilit “përshtatje e arsyeshme” do të thotë modifikim i nevojshëm dhe i duhur, apo përshtatje që nuk imponon *barrë disproporcionale ose të tepruar*, në një çështje specifike, me qëllim për t’i siguruar personit me paaftësi, gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore mbi baza barazie, njësoj si të tjerët.

22. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, gjithashtu, është shprehur mbi konceptin “përshtatje e arsyeshme”, në lidhje me një çështje, ku pretendimi bazohej në diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, duke sqaruar se trajtimi i diferencuar mund të jetë i pajustifikuar, kur nuk bëhen përshtatje të arsyeshme, në mënyrë që të drejtat themelore të kufizohen më pak, por edhe qëllimi i ligjvënësit të arrihet (*Glor kundër Zvicerës, aplikimi nr.13444/04, vendim i datës 6.11.2009, perifrashim prg.94-97*). Edhe direktiva 2000/78 e Këshillit Evropian “Mbi krijimin e kuadrit rregullator për trajtim të barabartë në marrëdhëniet e punësimit”, në nenin 5, përcakton se për të garantuar zbatimin e parimit të barazisë, në raport me personat me aftësi të kufizuara, duhet të ofrohet “përshtatja e arsyeshme”. Me këtë terminologji, kjo direktivë dikton që çdo punëdhënës duhet të marrë masat e përshtatshme, me qëllim që personit me aftësi të kufizuara t’i sigurohet akses, të përfshihet, të zhvillohet në punë, përveç rasteve kur këto masa do të përbënin një barrë disproporcionale për të (punëdhënësin).

23. Ndërkaq, Gjykata vëren se termi “përshtatje e arsyeshme” reflektohet edhe në disa legjisllacione të tjera, të vendeve të rajonit, mbi mbrojtjen nga diskriminimi, si: Maqedonia,¹ Kroacia² dhe Mali i Zi³. Nga të dhënat mbi këto legjisllacione rezulton se koncepti “përshtatje e arsyeshme” dhe terminologjia “barrë disproporcionale” janë pasqyruar në përmbajtjen e dispozitave ligjore konkrete, pa ndonjë dallim nga ligji shqiptar në këtë drejtim.

24. Sipas vlerësimit të Gjykatës, nga një vështrim i përgjithshëm në KPAK, por edhe në të gjitha legjisllacionet evropiane, rezulton se një dështim apo mohim për t’i ofruar një personi me aftësi të kufizuara një përshtatje të arsyeshme, do të krijonte dhe do të konsiderohej diskriminim mbi bazën e

¹Ligji mbi parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, nr.07-1583/1, datë 8.04.2010, ka përcaktuar në nenin 5/12, termin “përshtatje e infrastrukturës”, duke e përkufizuar si: “Përshtatja e infrastrukturës dhe e shërbimeve konsiderohet marrja e masave të duhura në raste të veçanta, me qëllim që t’i sigurohet personit me paaftësi intelektuale dhe fizike, akses, pjesëmarrja dhe progresi në proceset e punës, përveç se kur masat vendosin barrë/pengesë *disproporcionale* mbi punëdhënësin.”

²Ligji kundër diskriminimit (2008), në nenin 4 përcakton se dështimi për t’i siguruar një personi me aftësi të kufizuara, përdorim të burimeve publike, pjesëmarrje në jetën publike dhe sociale, akses në vendin e punës dhe kushtet e duhura të punës, duke përshtatur infrastrukturën dhe ambientet, të cilat nuk përbëjnë *barrë të paarsyeshme* për personin që është i detyruar t’i bëjë këto përshtatje, do të konsiderohet diskriminim.

³Ligji mbi ndalimin e diskriminimit, datë 27.07.2010, në nenin 18 përcakton se do konsiderohet diskriminim ndaj një personi me aftësi të kufizuara, parandalimi ose vështirësimi i aksesit në kujdesin shëndetësor, p.sh. mohimi i trajtimit mjekësor (...). Hyrja në ndërtesa dhe hapësira për përdorim publik, të cilat janë të paaksesueshme për personat me aftësi të kufizuara dhe që nuk përbëjnë një *barrë disproporcionale* për personin juridik apo fizik, që është i detyruar t’i sigurojë ato, do të konsiderohet diskriminim.



paaftësisë. Përshtatja ka kufizimet e veta, prandaj dhe legjislacionet kanë huazuar termin “e arsyeshme”. Ndërsa, nëse përshtatja do të vendosë barrë të tepruar apo disproporcionale për atë që ka detyrimin ta kryejë përshtatjen, atëherë kjo nuk do të konsiderohej diskriminim. Në këtë kontekst, edhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ka parashikuar specifikisht në nenin 5/2 se: “Mohimi i modifikimeve dhe përshtatjeve të duhura e të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara përbën diskriminim”.

25. Duke pasur parasysh sa më lart, kjo Gjykatë çmon se detyrimi për “përshtatjen e arsyeshme”, vetëm ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, është një diferencim kushtetues (i përligjur dhe objektiv), në funksion të garantimit të zbatimit të parimit të barazisë ndaj kësaj kategorie. Ndërsa termi “barrë e tepruar” është parashikuar në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi në përputhje me konceptin e ofruar nga KPAK-u, në kuadrin e parimit të proporcionalitetit dhe balancimit të interesave të kryqëzuara të personave me aftësi të kufizuara dhe atyre entiteteve publike apo private, që duhet t’u garantojnë përshtatje të arsyeshme. Për më tepër, termi “barrë e tepruar” ka gjetur vend dhe në nenin 20/3 të Ligjit, specifikisht në fushën e të mirave dhe shërbimeve dhe ku qartësisht del kuptimi i këtij termi, si barrë e cila nuk duhet të jetë e shpërpjesëtuar (*e tepruar*) për personin që ofron të mirat apo shërbimet dhe që ka detyrimin të bëjë përshtatjet e duhura dhe të nevojshme⁴.

26. Një pretendim tjetër i kërkuesve, i lidhur po me termin “barrë e tepruar”, është se duke mos pasur parashikime në Ligj që ta bëjnë të matshme barrën e tepruar, personat me aftësi të kufizuara ndodhen përballë rrezikut që për ta të përcaktohen rregulla dhe kritere që i diferencojnë nga qytetarët e tjerë.

27. Në vlerësimin e Gjykatës, mungesa e kritereve përcaktuese në Ligj të “barrës së tepruar”, nuk krijon papajtueshmëri me Kushtetutën, pasi janë organet zbatuese dhe kontrolluese të respektimit të këtij ligji, të cilat do të kenë mundësi të interpretojnë “përshtatjen e arsyeshme” rast pas rasti. Ky interpretim do të realizohet nga këto organe në varësi të natyrës së pretendimeve, si dhe mundësisë për kryerjen e rregullimeve/ndryshimeve të arsyeshme nga ana e subjektit, mbi të cilin bie detyrimi i përshtatjes dhe mbi të cilin nuk duhet imponuar barrë disproporcionale.

28. Në zbatim të vlerësimeve të mësipërme të saj, Gjykata konkludon se pika 7 e nenit 3 të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, nuk bie në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës për shkak të termit “barrë e tepruar”.

B. Për pretendimin për diskriminim për shkak të konceptit ligjor “organizatat me interesa legjitime”, përcaktuar në pikën 9 të nenit 3 të Ligjit

29. Kërkuesit pretendojnë se përkufizimi i dhënë me Ligj mbi konceptin “organizata me interesa legjitime”, nuk diferencon organizatat e personave *me* aftësi të kufizuara, pra që në anëtarësi kanë persona me aftësi të kufizuara nga organizatat *për* persona me aftësi të kufizuara. Sipas tyre, organizatat *për* personat me aftësi të kufizuara krahasuar *me* organizatat e personave me aftësi të kufizuara, mund të kenë më shumë shanse për thithje fondesh, ndërsa të dytat janë më të varfra, prandaj dhe duhet të kenë mbrojtje më të madhe ligjore në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të vetëpërfaqësohen në procese advokatie, promovimi dhe monitorimi. Po ashtu, ata argumentojnë se KPAK-u e bën këtë dallim.

30. Gjykata konstaton se neni 32 i KPAK-ut sanksionon se shtetet anëtare njohin rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe promovimin e tij, në mbështetje të përpjekjeve kombëtare për realizimin e qëllimit dhe objektivave të Konventës, dhe do të ndërmarrin masat e duhura dhe efektive në këtë drejtim, ndërmjet shteteve dhe, sipas rastit, në partneritet me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale dhe shoqërinë civile, në veçanti, organizatat e personave me aftësi të kufizuara (*përkthim i gjykatës*).

31. Sipas vlerësimit të Gjykatës, KPAK-u, edhe pse thekson rolin qendror të organizatave të

⁴Neni 20/3 i Ligjit: Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.

personave me aftësi të kufizuara, nuk parashikon rolin ekskluziv të këtyre organizatave në procese advokatie, promovimi dhe monitorimi në funksion të mbrojtjes dhe sigurimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

32. Ndërsa, duke iu referuar ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, Gjykata konstaton se termi “organizata me interesa legjitime” përdoret në dy dispozita ligjore, në nenin 33, ku parashikohen procedurat e shqyrtimit të ankesave para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe në nenin 34, për procedurat para gjykatës. Duke iu referuar këtyre dispozitave, rezulton se procedurat para Komisionerit dhe para gjykatës nuk mund të fillojnë *pa akt përfaqësimi* nga individ që pretendon diskriminim, që jo domosdoshmërisht duhet të jetë individ me aftësi të kufizuara.

33. Nëpërmjet interpretimit sistematik të dispozitave të mësipërme të Ligjit, arrihet qartësisht në përfundimin se qëllimi i përkufizimit “organizata me interesa legjitime” është të garantohet përfaqësimi në gjykatë për të gjithë individët që pretendojnë diskriminim, mbi çfarëdo arsye/shkak të përcaktuar me ligj, me pëlqimin e tyre, nga organizatat që janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se ky term nuk duhet interpretuar i shkëputur nga kërkesit, sepse Ligji, objekt shqyrtimi, në pjesën e përkufizimit mbi organizatat me interesa legjitime, nuk ka pasur parasysh vetëm personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat që janë krijuar *prej tyre* apo veprojnë *për* mbrojtjen e tyre, por edhe një sërë organizatash të tjera që kanë objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e kategorive të tjera të shoqërisë, subjekt diskriminimi për shkaqe të ndryshme.

34. Po në këtë drejtim, edhe neni 9/2 i direktivës 2000/78 të KE-së “Mbi krijimin e kuadrit rregullator për trajtim të barabartë në marrëdhëniet e punësimit”, mbi të cilën është bërë përafrimi i ligjit, përcakton se shtetet anëtare duhet të sigurojnë që shoqatat, organizatat apo subjektet e tjera ligjore, të cilat kanë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionet e tyre kombëtare, një interes të ligjshëm, të mund të angazhohen, ose në emër ose në mbështetje të ankuesit, *me miratimin e tij ose të saj*, në çdo procedurë gjyqësore dhe /ose administrative të parashikuar për zbatimin e detyrimeve sipas kësaj direktive.

35. Po kështu, Gjykata vlerëson se e drejta e përfaqësimit *a priori* nuk i merret asnjë personi me aftësi të kufizuara, nga organizatat me interesa legjitime, qofshin organizata të këtyre personave apo *për* këta persona, sikundër pretendojnë kërkesit. Sipas Gjykatës, ligjvënësi me mosbërjen e dallimit mes dy kategorive të organizatave, ka pasur parasysh pikërisht mbrojtjen e interesave të individëve që vuajnë diskriminimin, përfshirë edhe të personave me aftësi të kufizuara, duke u dhënë mundësinë e zgjedhjes për mbrojtjen e interesave të tyre, qoftë nga organizata me anëtarë - persona me aftësi të kufizuara, apo nga organizatat që punojnë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

36. Së fundmi, në lidhje me pretendimin e kërkesve për të pasur të drejtën ekskluzive të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara *vetëm* organizatat e personave me aftësi të kufizuara, Gjykata çmon se nëse ligji do të bënte një parashikim të tillë, kjo do të sillte kushtëzim të së drejtës së këtyre personave për të zgjedhur lirisht përfaqësuesin ligjor. Prandaj, në këndvështrimin e Gjykatës, pika 9 e nenit 3 të Ligjit jo vetëm nuk cenon standardet e kërkuara nga neni 18 i Kushtetutës, por krijon më shumë hapësirë për përfaqësimin ligjor të personave me aftësi të kufizuara.

37. Gjykata, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të kërkesve, arrin në përfundimin se përkufizimet në pikat 7 dhe 9, të nenit 3, të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, nuk bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 18 të Kushtetutës. Për këtë arsye, kërkesa për vlerësimin e përcaktimeve ligjore, objekt shqyrtimi, si të papajtueshme me Kushtetutën është e pabazuar dhe, për rrjedhojë, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a e 134/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,



VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari.

VENDIM

Nr. 49, datë 21.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Gani Dizdari	Anëtar i	“	“

me sekretare Elta Milori, në datën 17.09.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr.28 Akti, që i përket:

KËRKUES: Ëngjëll Hysenbegasi, Daniela Cetri, Lindita Lulaj, Isuf Melçani, Mjeser Minarolli, Shkëlqim Minarolli, Luljeta Mulosmani, Fatlinda Selenica, Hysnie Minarolli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zhuli Bregasi, Hektor Bregasi, Viliam Bregasi, bashkia Pogradec.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.255, datë 10.02.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; i vendimit nr.282, datë 09.10.2009, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe i vendimit nr.00-2012-2408, datë 15.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29, 30 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi pretendimet e kërkuësve, të cilët kërquan pranimin e kërkesës, dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësit Ëngjëll Hysenbegasi, etj., dhe subjektet e interesuara Zhuli Bregasi, etj., janë përkatësisht trashëgimtarë ligjorë të vëllezërve Starova. Të dyja palët, me kërkesa të veçanta, i janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), pranë bashkisë Pogradec, duke kërkuar: *kërkuësit* - të njihen bashkëpronarë mbi objektin ish-muze dhe një godinë dykatëshe pas tij; *subjektet e interesuara* - të njihen pronarë të vetëm mbi këto objekte. Vendimet e KKKP-së, që kanë njohur bashkëpronarë mbi këto objekte trashëgimtarët e dy vëllezërve Starova, janë kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.255, datë 10.02.2005, ka vendosur pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit të KKKP-së Pogradec, si dhe njohjen e pronësisë vetëm për trashëgimtarët e Neki Starovës.

3. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.122, datë 25.05.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.255, datë 10.02.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.317, datë 15.03.2007, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë.

5. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr.23, datë 04.11.2008, ka vendosur: shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.122, datë 25.05.2005, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr.317, datë 15.03.2007, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Korçë.

6. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.282, datë 09.10.2009, ka vendosur: lënien në fuqi të vendimit nr.255, datë 10.02.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2012-2408, datë 15.11.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese

8. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë. Ata kanë pretenduar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

8.1 Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka gjykuar çështjen me një gjyqtar, ndërkohë që duhej të gjykohej me trup gjykues prej tre gjyqtarësh, pasi vlera e padisë ishte mbi 3 milionë lekë;

8.2 Gjykata e Apelit Korçë, gjatë rigjykimit, nuk ka marrë parasysh urdhërimet e Gjykatës Kushtetuese;

8.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) nuk ka dhënë një vendim përfundimtar për zgjidhjen e çështjes, duke cenuar parimin e arsytimit të vendimit;

8.4 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi gjendja e bashkëpronësisë është prishur me vendime gjyqësore;

8.5 Është cenuar parimi i paanshmërisë nga Gjykata e Apelit Korçë, duke dhënë një vendim shumë të shpejtë, pas kthimit për rishqyrtim nga Gjykata Kushtetuese.

9. *Subjektet e interesuara Zhuli Bregasi, Hektor Bregasi dhe bashkia Pogradec* nuk paraqitën prapësime me shkrim për pretendimet e parashtruara nga kërkuesit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

10. Kërkuesit kanë pretenduar se gjatë procesit gjyqësor, të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosrespektimit të së drejtës së gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të paanësisë, parimit të arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe parimit të sigurisë juridike.

11. Gjykata Kushtetuese, pas marrjes në shqyrtim të pretendimeve, gjatë votimit të çështjes nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj⁵, të kërkuar nga neni 133, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 72, pika 1, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

12. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkesa duhet të refuzohet. Në bazë të nenit 74 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesit të paraqesin përsëri kërkesë, në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

⁵ Gjyqtarët: Bashkim Dedja, Sokol Berberi dhe Gani Dizdari, votuan për pranimin pjesërisht të kërkesës.

Gjyqtarët: Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj dhe Fatmir Hoxha, votuan për rrëzimin e kërkesës.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72, 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur në Tiranë, më 26.09.2013

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha.

VENDIM

Nr. 50, datë 21.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Gani Dizdari	Anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	Anëtar i	“	“
Fatos Lulo	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 02.10.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 21 Akti, që i përket:

KËRKUES: Muhamet Curra

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, studio përmbartimore “Debit Collection”,

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të procesit të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 1036, datë 07.08.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm.

Dëshmipërblimi i dëmit të ardhur nga mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë, (DPTT) që prej datës 17.07.2000. Me urdhrin nr. 241, datë 02.04.2008, subjekti i interesuar, në cilësinë e 7882

punëdhënësit, ka ndërprerë marrëdhënien e tij të punës dhe marrëdhëniet financiare, duke filluar nga data 10.04.2008.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi është investuar nga kërkuesi me padi me objekt “dëmshpërblim për largim të pajustificuar nga puna dhe mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës”, me vendimin nr. 1401, datë 24.02.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadiës.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, pas ankimit të kërkuesit, me vendimin nr. 1036, datë 07.08.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1401, datë 24.02.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe detyrimin e palës së paditur, t’i paguajë kërkuesit shumat përkatëse (pagën e 8 muajve për largim të pajustificuar nga puna; pagën e 2 muajve për mosrespektim të procedurave të largimit nga puna si dhe pagën e 4 muajve për vjetërsi pune). Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe në zbatim të tij, është nxjerrë urdhri i ekzekutimit nr. 3171, datë 09.12.2010.

4. Subjekti i interesuar, DPTT-ja, ka ushtruar rekurs kundër këtij vendimi dhe, në kohën e paraqitjes së kësaj kërkesë, Gjykata e Lartë nuk e kishte shqyrtuar ende rekursin dhe nuk kishte marrë vendim në lidhje me të. Vendimi për këtë çështje është marrë nga Gjykata e Lartë në datën 05.07.2013 (nr. 00-2013-1574).

5. Kërkuesi i është drejtuar përmbaruesit privat “Debit Collection” (subjekt i interesuar) dhe ka filluar, në datën 17.05.2011, procedurat e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë. Edhe pas kryerjes së veprimeve përmbarimore nga subjekti i interesuar, ende vendimi gjyqësor i formës së prerë mbetet i paekzekutuar.

6. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosëkzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 1036, datë 07.08.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm.

7. **Subjekti i interesuar**, Studio “Debit Collection”, ka paraqitur me shkrim informacionin, lidhur me ecurinë e praktikës përmbarimore me palë kreditore kërkuesin.

8. **Subjekti tjetër i interesuar**, DPTT-ja, nuk ka paraqitur prapësime apo komente me shkrim.

II

Vlerësimi i Gjykatës

A) Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, për shkak të mosëkzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

9. Kërkuesi pretendon se, që prej marrjes formë të prerë të vendimit nr. 1036, datë 07.06.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka kaluar një kohë e gjatë dhe e pajustificuar për ekzekutimin e këtij vendimi, në shkelje të nenit 42 të Kushtetutës.

10. Gjykata është shprehur edhe më parë në jurisprudencën e saj se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (shih vendimet nr. 4, datë 20.02.2013; nr. 1, datë 20.01.2012; nr. 2, datë 01.02.2011; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë. Çdo



organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 4, datë 20.02.2013; nr. 6, datë 06.03.2009; nr. 1, datë 19.01.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se, në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 4, datë 20.02.2013; nr. 10, datë 01.03.2012; nr. 21, datë 03.06.2011; nr. 14, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Çështja konkrete është vlerësuar në vijim nga Gjykata, në vështrim të respektimit të standardeve të mësipërme.

i) Kompleksiteti i çështjes

14. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka pohuar vazhdimisht se, për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 4, datë 20.02.2013; nr. 7, datë 27.02.2012; nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 14, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 1036, datë 07.08.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm, në lidhje me dëmshpërblimin që duhet të marrë kërkuesi, për shkak të largimit të pajustificuar nga puna dhe mosrespektimit të procedurave të largimit nga puna. Duke iu referuar materialeve shkresore, Gjykata konstaton se çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të subjektit të interesuar, DPTT-së.

ii) Sjellja e kërkuesit

16. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve (*shih vendimet nr. 50 datë 22.11.2011 dhe nr. 14, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për rivendosjen e të drejtës së cenuar. Nga tërësia e fakteve dhe rrethanave, rezulton se: kërkuesi ka depozituar pranë shërbimit përmbartimor privat “Debit Collection” urdhrin e ekzekutimit nr. 3171, datë 09.12.2010, së bashku me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 1036, datë 07.08.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka paguar taksën përmbartimore. Këto veprime të kërkuesit tregojnë se ai e ka ushtruar mjetin ligjor në dispozicion për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale. Gjykata është shprehur se “lidhur me pretendimin për shkeljen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të shqyrtojë nëse ka pasur mjete të cilave pala kërkuese duhet t’u drejtohej. Në këtë drejtim, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në kuptim të nenit 13 të Konventës, mjetet në dispozicion të një ndërgjyqësi për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit janë “efektive”, në qoftë se ato “parandalojnë shkeljen e pretenduar apo pengojnë vazhdimin e saj, apo ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur” (*shih vendimin nr. 12, datë 05.03.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në këndvështrim të legjislacionit procedural civil kërkuesi, në rastin konkret, nuk ka mjete të tjera të tjera ligjore efektive në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Nga sa më sipër, në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezulton që sjellja e kërkuesit të jetë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

iii) Sjellja e autoriteteve

19. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të

përgjigjen njëloj. Organet shtetërore duhet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga një vendim gjyqësor sapo vendimi të bëhet i ekzekutueshëm (*shih vendimet nr. 46, datë 25.07.2012; nr. 7, datë 27.02.2012; nr. 35, datë 27.10.2010 dhe nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Mbi bazën e akteve shkresore të administruara, rezulton se, pas fillimit të procedurave për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, përmbaruesi gjyqësor privat ka kryer këto veprime: lajmërim për ekzekutim vullnetar nr. 27/a, datë 17.05.2011; vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm nr. 27, datë 08.06.2011; urdhër për vendosjen e sekuestros konservative nr. 119 Prot., nr. 27 Regj., datë 15.06.2012, për shumën 1 215 545 lekë, drejtuar degës së thesarit Tiranë; paralajmërim për gjobë nr. 118/9, datë 17.09.2012, drejtuar DPTT-së; urdhër vendosje sekuestro konservative nr. 119/3 Prot., nr. 24 Regj., datë 10.01.2013, drejtuar degës së thesarit Tiranë.

21. DPTT-ja, pas dërgimit të shkresës për ekzekutim vullnetar, i ka dërguar përmbaruesit privat një kërkesë për plotësimin e dokumentacionit (shkresa 10570 prot., datë 09.06.2011). Përmbaruesi privat e ka dërguar dokumentacionin e plotësuar në datën 10.07.2011, pra një muaj pas dërgimit të kërkesës (shkresa 27/B, datë 10.07.2011). Përsëri nga ana e DPTT-së është konstatuar mungesë dokumentacioni dhe i është kërkuar përmbaruesit të dërgojë vendimin e munguar të Gjykatës së Lartë (shkresa 14553 prot., datë 05.08.2011). Më pas, dega e thesarit Tiranë ka vendosur sekuestro konservative ndaj DPTT-së (shkresa 1309/2 prot., datë 10/04/2013). Edhe pse kanë kaluar 5 vjet nga largimi i kërkuarit nga puna, DPTT-ja ende nuk e ka ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë. Po kështu, Gjykata vëren se rekursi në Gjykatën e Lartë është regjistruar në datën 24.09.2010 dhe vendimi është marrë në datën 05.07.2013. Koha e gjatë që ka kaluar përpara se çështja të shqyrtohej nga Gjykata e Lartë ka shkaktuar vonesa të mëtejshme në përfundimin e çështjes gjyqësore në shkallët e juridiksionit të zakonshëm.

22. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata konstaton se kanë kaluar rreth 2 vjet e tetë muaj nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit, nr. 3171, datë 09.12.2010, i cili ende nuk është zbatuar. Në vlerësimin e Gjykatës, mosekzekutimi, nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, i vendimit të formës së prerë nr. 1036, datë 07.08.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është i pajustificuar.

23. Për pasojë, Gjykata çmon se mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm, ka sjellë cenimin e të drejtës së kërkuarit për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

B) Për pretendimin e dëmshpërblimit të dëmit të ardhur nga mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

24. Kërkuari ka pretenduar përpara Gjykatës edhe kompensim për dëmin e shkaktuar nga vonesa në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm.

25. Gjykata ka nënvizuar se në sistemin tonë ligjor, kushdo që konsideron se ka pasur një shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, mund t'i drejtohet kësaj Gjykate, pasi ka shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike, në kuptim të nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës.

26. Për sa i përket kërimit për kompensimin e dëmit, si rezultat i ekzekutimit me vonesë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se ky është një kërkim i ri, i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në bazë të dispozitave të Kodit Civil, që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar, si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume të hollash. Vetëm pas shterimit të mbrojtjes juridiksionale, kërkuari mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 11, datë 12.04.2011; nr. 8, datë 23.03.2010 dhe nr. 27, datë 20.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa për dëmshpërblim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,



VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 1036, datë 07.08.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.

VENDIM
Nr. 51, datë 21.11.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	Anëtar i “ “
Gani Dizdari	Anëtar i “ “
Besnik Imeraj	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 19.09.2013 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.30 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Mirela Sinani

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve: nr.2080, datë 23.03.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (pjesërisht); nr.792, datë 15.04.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.00-2011-296, datë 06.04.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 18/1, 41, pika 1 dhe 5, 42, 43, 58 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 7 dhe 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

GYJKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe prapësimet me shkrim të subjekti të interesuar, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja është krijuese e libretit të operës “Dhoma”, e cila është vënë në skenë nga Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit (TKOBAP) në vitin 2004. Ky projekt është mbështetur financiarisht nga fondet artistike të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e cila me urdhrin nr.305, datë 08.10.2004, ka vendosur: “Të mbështesë financiarisht në shumën 1 115 000 lekë vënien në skenë të 7886

operës “Dhoma” të kompozitorit E.D.”, prej të cilave 100 000 lekë i janë paguar kompozitorit dhe pjesa e mbetur për skenografinë. Shpenzimet artistike dhe ato teknike janë përballuar nga TKOBAP-i.

2. Duke pretenduar të drejtën për t’u shpërblyer për përdorimin e krijimtarisë artistike, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt *“Dëmshpërblim nga përdorimi i pronësisë artistike në shumën 2 000 000 lekë, shpërblim për fitimin e munguar, shpërblim për dëmin e shkaktuar nga cenimi në nderin dhe personalitetin”*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2080, datë 23.03.2007, ka vendosur *“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë: detyrimin e palës së paditur, Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, të shpërblejë paditësen për përdorimin e pronësisë artistike në vlerën 571 365 lekë, si dhe fitimin e munguar të kësaj shume për periudhën 09.05.2004 deri më 20.10.2006, në vlerën 74 378 lekë dhe, pas kësaj date, në vlerën 83.19 lekë çdo ditë; Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër...”*

3. Gjykata e Apelit Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur nga paditësja dhe pala e paditur (TOB), në mungesë të palëve, me vendimin nr.792, datë 15.04.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Gjykata e Lartë, me vendimin nr.00-2011-296, datë 06.04.2011, ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit të paraqitur nga paditësja me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

5. **Kërkesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 05.04.2013, me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të marra gjatë procesit gjyqësor civil të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, duke pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

5.1 Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë:

5.1.1 Është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi në shkellje të neneve 13 dhe 15 të KPC-së jo vetëm nuk janë pranuar dokumente të siguruara nga kërkesja, por i janë kërkuar MTKRS-së dhe TOB-it të paraqesin dokumentet zyrtare që dispononin lidhur me caktimin e dëmshpërblimit të paditëses. Në shkellje të nenit 227 të KPC-së dhe nenit 34/2 të ligjit “Për të drejtën e autorit” nuk është pranuar kërkesa për riekspertim, për faktin se akti i ekspertimit bazohej vetëm në tri të dhëna (pagesa e skenografit, fondi shtesë për shpenzimet e shfaqjes, билетat e shitura), duke reduktuar zërat përbërës të të ardhurave të shfrytëzimit.

5.1.2 Është lejuar zhvillimi i procesit gjyqësor tej afatit të arsyeshëm, pasi në shkellje të nenit 175 të KPC-së: i) seancat gjyqësore janë shtyrë si në rastet e mungesës, pa shkaqe ligjore, të avokatëve të palëve të paditura, ashtu dhe me iniciativën e gjyqtarës; ii) thirrja e ekspertit kontabël, të kërkuar nga pala e paditur, mban datën 18.01.2006, ndërkohë që eksperti është paraqitur vetëm në datën 17.03.2006, ndërsa betimin e ka kryer në datën 09.05.2006; iii) gjithashtu, nuk janë respektuar kërkesat procedurale të parashikuara në nenet 225-230 të KPC-së lidhur me caktimin e ekspertit dhe ekspertimit; iv) gjyqtarja, në shkellje të parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë, ka lejuar zvarritjen e procesit gjyqësor për 32 seanca (11.10.2005–23.03.2007) duke lejuar mosparaqitjen e dokumenteve zyrtare nga institucionet shtetërore, duke u bërë palë me to në caktimin e një shpërblimi minimal në cenim të së drejtës së autorit.

5.1.3 Janë shkelur kërkesat e nenit 178 të KPC-së lidhur me sigurimin e rregullit dhe qetësisë në seancë gjyqësore, pasi gjyqtarja ka mbajtur qëndrime të njëanshme ndaj fjalëve provokuese dhe fyese të përfaqësueses ligjore të palës së paditur.

5.1.4 Është cenuar dinjiteti njerëzor i kërkuësës, duke mos i njohur asaj dëmin moral të shkaktuar nga MTKRS-ja, në kundërshtim me nenin 58 të Kushtetutës dhe nenet 10, 11 dhe 48 të ligjit “Për të drejtën e autorit”.

5.1.5 Është cenuar standardi kushtetues i arsyetimit të vendimit, pasi vendimi përmban kontradiksione logjike. Gjyqtarja shtrembëron pozicionin e MTKRS-së, duke e cilësuar si sponsor që mbështet një organizator privat dhe jo si institucioni qendror i kulturës që administron pronësinë artistike. Po ashtu, gjyqtarja mohon të drejtat pasurore dhe jopasurore të palës paditëse (autores së libretit) në referim të nenit 625 të KPC-së dhe neneve 10-13 të ligjit “Për të drejtën e autorit”.

5.2 Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë:



5.2.1 Nuk janë respektuar kërkesat procedurale për njoftimin e palëve ndërgjyqëse, duke lejuar zhvillimin e gjykimit në mungesë.

5.2.2 Po ashtu, nuk është respektuar standardi kushtetues i arsyetimit të vendimit, pasi nuk i jepen përgjigje pretendimeve të palëve, të cilat kanë qenë në mungesë.

5.3 Gjykata e Lartë:

5.3.1 Ka cenuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, duke vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, edhe pse përmbante shkaqe për kalimin në seancë.

5.3.2 Nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit.

6. **Subjekti i interesuar, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP),** paraqiti me shkrim prapësimet e mëposhtme:

6.1 Pretendimet e kërkuësës kanë të bëjnë me rivlerësimin e detyrimit monetar e moral, detyrim i cili, bazuar në vendimin nr.8324, datë 13.07.2012 “Për lëshim urdhër ekzekutimi” është duke u ekzekutuar me këste pjesore prej muajit mars 2013, pavarësisht se nuk ka pasur shtesë fondi nga MTKRS-ja.

6.2 Detyrimi monetar dhe moral nuk i përket TKOBAP-it, pasi si institucion varësie i MTKRS-së, thjesht ka vënë në skenë një vepër e cila është miratuar si projekt i vetë Ministrisë, për krijimin e të cilës nuk ka pasur kërkesë nga TKOBAP-i. Kjo e fundit, në çdo rast respekton të drejtën e autorit dhe detyrimet ligjore që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.04.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera lidhur me të”.

6.3 Vlera e shpërblimit që është kundërshtuar gjyqësisht nga kërkuësja është llogaritur nga eksperti kontabël, i caktuar me vendimin e ndërmjetëm të gjykatës, gjatë procesit gjyqësor të vënë në lëvizje në vitin 2004 nga vetë kërkuësja, kurse TKOBAP-i ka marrë pjesë në atë proces vetëm prej datës 20.10.2006.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe parimit të kontradiktoritetit, të garantuar nga neni 42/2 i Kushtetutës

7. Gjykata, në jurisprudencën e saj konstante, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, i paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr.34, datë 03.10.2007; nr.34, datë 25.07.2011; nr.18, datë 23.04.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në

proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr.19, datë 12.06.2003; nr.18, datë 23.04.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në referim të nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit të çështjeve bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatën e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ankimuar. Po ashtu, neni në fjalë përcakton se afati kohor për njoftimin e palëve është 10 ditë përpara shqyrtimit të çështjes.

10. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore, gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë është zhvilluar pa praninë e palëve. Procesverbali i datës 15.04.2008 mban shënimin “*gjykata vendosi gjykimin në mungesë, ka(në) dijeni me shpallje sipas ligjit*”. Në përfundim të procesit, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11. Po ashtu, gjatë gjykimit kushtetues të çështjes, është administruar shkresa nr.1539 prot, datë 20.06.2013, e kancelares së Gjykatës së Apelit Tiranë, bashkëngjitur së cilës gjendet një kopje e listës së gjykimeve, ku rezultojnë të jetë edhe emri i kërkuësës (nr. rendor 15). Kurse nga shkresa nr. 7492, datë 12.06.2013, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezultojnë se: “*...listat e gjyqeve të ardhura nga Gjykata e Apelit Tiranë, për gjykimet e asaj gjykate, afishohen në stendat e shpalljeve në hollin e katit të parë, ku qëndrojnë deri në datën e gjykimit. Pas kësaj date listat asgjësohen*”.

12. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata, bazuar në faktin se njoftimi i kërkesës për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes është bërë nga Gjykata e Apelit Tiranë me shpallje pranë saj, duke i afishuar në datën 01.04.2008 listat e çështjeve për gjykim në datën 15.04.2008, po ashtu, në mungesë të ndonjë prove të kundërt të paraqitur nga kërkuësja për të justifikuar pamundësinë objektive dhe të arsyeshme për të mos kontrolluar listat e shpallura, vlerëson se pretendimi i kërkuësës, për mosrespektimin e procedurave të njoftimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, është i pabazuar.

B. Në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

13. Sipas kërkuësës, gjykatat e zakonshme nuk kanë respektuar kërkesat e nenit 142/1 të Kushtetutës në lidhje me arsyetimin e vendimit gjyqësor. Vendimi i Gjykatës së Apelit përmban kontradiksione logjike, kurse vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për mospranimin e rekursit, në dhomë këshillimi, nuk është shprehur për shkaqet konkrete të mospranimin.

14. Bazuar në jurisprudencën kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr.3, datë 19.02.2013; nr.8, datë 28.02.2012; nr.25, datë 10.06.2011 dhe nr.38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi të dhënat që gjenden në aktet dhe që janë shqyrtuar gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në dhënin e vendimit. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë, përfundimisht, qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr.8, datë 16.03.2011; nr.23, datë 04.11.2008; nr.11, datë 02.04.2008 dhe nr.7, datë 09.03.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës



arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr.3, datë 19.02.2013; nr.20, datë 13.04.2012 dhe nr 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr.25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr.3, datë 19.02.2013; nr.55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nën dritën e standardeve të mësipërme dhe të natyrës së pretendimeve të parashtruara nga kërkuesja në lidhje me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykata vlerëson se ky pretendim është haptazi i papabazuar.

20. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480). Kurse për sa i përket vendimit të gjykatës, në referim të nenit 310/1 të KPC-së, parashikohet se duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve.

21. Nga parashikimet e normave të mësipërme procedurale, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr.3, datë 19.02.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, në pjesën hyrëse përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs kërkuesja, por nuk përmban shkaqet që ajo ka parashtruar në rekurs. Ndërsa në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se “rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së” duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij.

23. Në të tilla rrethana, Gjykata ka vlerësuar se nga leximi në tërësi i vendimit, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht

se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre (shkaqeve) nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv. Në këtë kuptim, pjesët e vendimit nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda tij, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme. Mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsytimit të gjykatës.

24. Mosparaqitja, në vendimin e Kolegjit Civil, e shkaqeve të parashtruara nga kërkuesja në rekurs, *prima facie*, krijon dyshime edhe mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv si dhe të të drejtës për t'u dëgjuar, të pretenduara edhe nga vetë kërkuesja. Në këtë vështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor.

25. Në përfundim, Gjykata vlerëson se vendimi i mospranimit të rekursit, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

C. Në lidhje me pretendimet e tjera

26. Kërkuesja ka pretenduar, gjithashtu, se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor nuk është respektuar parimi i barazisë së armëve, afati i arsyeshëm i gjykimit, rregulli, qetësia dhe etika në seancë gjyqësore dhe standardi kushtetues i arsytimit të vendimit.

27. Në jurisprudencën e saj të konsoliduar, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr.3, datë 19.02.2013; nr.31, datë 05.07.2011; nr.22, datë 22.07.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në vështrim të standardit të mësipërm, si dhe nisur nga natyra e argumenteve të parashtruara nga kërkuesja në mbështetje të pretendimeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e gjykatave të zakonshme dhe, për rrjedhojë, nuk i përkasin juridiksionit kushtetues. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkueses është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses, për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë proceseve gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, janë pjesërisht të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës⁶.
 - Shfuqizimin e vendimit nr.00-2011-296, datë 06.04.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

⁶ Gjyqtari V.Kristo votoi edhe për shfuqizimin e vendimit nr.792, datë 15.04.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë.



Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj.

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha.

MENDIM PARALEL

1. Në rastin në shqyrtim, pajtohem me vendimin e shumicës për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.00-2011-296, datë 06.04.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por nuk ndaj të njëjtin qëndrim lidhur me argumentet mbi të cilat shumica e mbështet vendimin në fjalë. Gjithashtu, ndryshe nga ky qëndrim, vlerësoj se rivendosja e të drejtave të kërkuësës, që lidhen me respektimin e disa parimeve themelore kushtetuese në kuadër të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sikurse do të trajtohet më poshtë, bëhet e mundur duke shfuqizuar edhe vendimin nr.792, datë 15.04.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Për rrjedhojë, duke qenë se çështjen në fjalë e shoh nga një këndvështrim tjetër, në vijim po jap arsyet e këtij mendimi paralel.

2. Duke konsideruar pretendimet e kërkuësës që janë ngritur në nivel kushtetues, kjo e fundit ka parashtruar se Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka respektuar kërkesat procedurale për njoftimin e palëve, duke lejuar zhvillimin e gjykimit në mungesë të tyre; ndërsa Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe nuk ka respektuar standardin e arsytimit të vendimit.

Lidhur me gjykimin në Gjykatën e Apelit Tiranë

3. Shumica, pasi ka konstatuar faktin se njoftimi i kërkuësës për ditën dhe orën e gjykimit të çështjes është bërë nga Gjykata e Apelit Tiranë, me shpallje pranë saj, si dhe në mungesë të ndonjë prove të kundërt të paraqitur nga kërkuësja për të justifikuar pamundësinë objektive dhe të arsyeshme për të mos kontrolluar listat e shpallura, ka vlerësuar se pretendimi për mosrespektimin e procedurave të njoftimit nga Gjykata e Apelit është i pabazuar.

4. Gjykata ka theksuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces (*shih vendimin nr.5, datë 25.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, nisur nga tërësia e rrethanave të çështjes, jam i mendimit se vlerësimi i shumicës, lidhur me pretendimin e kërkuësës për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, është i gabuar. Ndonëse Gjykata e Apelit formalisht ka plotësuar detyrimin ligjor për njoftimin e palëve, nëpërmjet shpalljes së datës së gjyqit sipas përcaktimeve të nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile, çmoj se gjykimi i një çështjeje në apel, pa praninë e asnjërës prej palëve, duhet të jetë një përjashtim, duke pasur si pikësynim, në çdo rast, respektimin e disa parimeve themelore të lidhura ngushtë me procesin e rregullt ligjor, si e drejta për t'u dëgjuar, parimi i kontradiktoritetit, e drejta e aksesit, e ankimit efektiv etj.

5. Në këtë aspekt, duke pasur parasysh karakteristikat e gjykimit në apel, ku, sipas nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, me kërkesë të palëve ose edhe kryesisht, gjykata përsërit tërësisht ose pjesërisht hetimin gjyqësor, si dhe faktin që në këtë shkallë vendimi merr formë të prerë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim merr një rëndësi të veçantë.

6. Nga ana tjetër, sikurse thekson edhe shumica, disa standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve. Për pasojë, e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, i paraprin të drejtave të tjera, pasi njoftimi për datën dhe orën e seancës përbën premisën për të pasur mundësinë objektive për ushtrimin e të drejtave të tjera të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 18, datë 23.04.2013; nr.34, datë 25.07.2011; nr.34, datë 03.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Nga sa më sipër, nisur nga kompetencat e Gjykatës së Apelit, si dhe në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të drejtë, vlerësoj se gjykata duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të garantuar pjesëmarrjen e palëve në gjykim. Në këtë drejtim, shtyrja e gjykimit të çështjes në një datë tjetër, në raste të kësaj natyre, do të përbënte një veprim të shëndetshëm për garantimin e parimeve themelore të lidhura me procesin e rregullt ligjor.

Lidhur me gjykimin në Gjykatën e Lartë

8. Arsytimin për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, shumica e mbështet vetëm në konstatimin e faktit se në pjesën hyrëse të tij nuk janë pasqyruar shkaqet për të cilat rekursuesja ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit. Sipas shumicës, një mangësi e tillë krijon dyshime mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv dhe të drejtës për t'u dëgjuar. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, për shfuqizimin e vendimit, sikurse jam shprehur dhe më parë (*shih mendimin paralel të vendimeve nr. 31, datë 10.07.2013; nr.26, datë 24.06.2013; nr. 22, datë 20.05.2013; nr. 3, datë 19.02.2013, të Gjykatës Kushtetuese*), nuk jam në një mendje me argumentet në të cilat ajo e mbështet vendimin e saj. Paraqitja formale (ndonëse e nevojshme) e pretendimeve në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë, në vlerësimin tim, megjithëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë, mbetet skematike dhe e padobishme, pa vlerësuar atë që është më e rëndësishme në një vendim gjyqësor, pikërisht pjesën arsyetuese e cila lidhet drejtpërdrejt me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit.

9. Një qëndrim i tillë i shumicës, mbi të gjitha, jo vetëm anashkalon jurisprudencën e kësaj Gjykate lidhur me unitetin dhe logjikën e vendimit në të gjitha elementet përbërëse të tij, por edhe nuk i shërben aspak kërkuarës, e cila pretendimet e saj për proces të parregullt ligjor i lidh me cenimin e të drejtave të saj kushtetuese. Duke përmbledhur mendimin tim tashmë të njohur, vlerësoj se një riformulim i vendimit nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në linjën e kërkuar nga shumica e kësaj Gjykate, nuk i shërben efektivitetit të gjykimit kushtetues. Përveç formalizmit, ky vendim nuk përmbush pritshmëritë e kërkuarës, e cila, në këto rrethana, mund t'i drejtohet përsëri Gjykatës Kushtetuese lidhur me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në aspektet e pretenduara dhe të mbetura pa përgjigje.

10. Duke arsyetuar më tej, ndryshe nga shumica, jam i mendimit se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë cenon në thelb parimin e arsyetimit të vendimit, pasi nuk i jep përgjigje, qoftë dhe në mënyrë të përmbledhur, pretendimit të kërkuarës, sipas të cilës Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka respektuar kërkesat procedurale për njoftimin e palëve, edhe pse ky pretendim, nga sa u tha më lart, passjell shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta.

11. Në këtë drejtim, lidhur me vendimet e mospranimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Gjykata në jurisprudencën e saj, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet n.19, datë 19.07.2005; nr. 22, datë 06.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga sa më lart, në kushtet kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit, si dhe të parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor, jam i mendimit se Gjykata e Lartë duhet të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga kërkuarësja, si në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, ashtu dhe në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta. Në këtë këndvështrim, çmoj se edhe vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuarës të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

13. Si përfundim, edhe në respekt të parimit të ekonomisë gjyqësore, si dhe të drejtësisë efektive, vlerësoj se rivendosja e të drejtave të cenuara të kërkuarës bëhet e mundur vetëm përmes kthimit të çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Anëtar: Vladimir Kristo

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 24 lekë